

Fjalë nga mjedise të ndryshme shkollore

palestra - palestër

segreteria - sekretari

spogliatoi – dhomë zhveshjeje

mensa - mensë

biblioteca - bibliotekë

presidenza - presidencë

classe - klasë

bagno maschi – banjë meshkujsh

bagno femmine – banjë femrash

ascensore - ashensor

sala riunioni – dhomë mbledhjesh

bidelleria o portineria - portineri

cucina - kuzhinë

aula multimediale – sallë multimediatike – me mjete të ndryshme dixhitale informative

atrio – atrium ose sallë e madhe

aula polifunzionale – klasë me hapësirë shumëfunktionale

SHKOLLA U FLET PRINDERVE

Instituti ynë “Bruno da Osimo” ofron oraret shkollore të mëposhtëm:

KOPSHTI (SISTEMI PARA-SHKOLLOR)

“Il sorriso dei bimbi/Buzëqeshja e fëmijëve”, lagjja Abbadia, rruga Abbadia **Tel.071/781293**

E Hënë – e Premte 7.50-15.50

Dalja e parë ora: 12,00/12,15

Dalja e dytë: 13,15/14,00

“Madiba” Sheshi Giovanni XXIII **Tel. 071/7131508** Osimo

E Hënë – e Premte 7.45-15.45

Dalja e parë: 11,45/12,00

Dalja e dytë: 13,00/14,00

“Arcomagico” lagjja San Biagio, rruga Manzoni, 1, **Tel. 071/7202124**

E Hënë – e Premte 7.45-15.45

Dalja e parë: 11,45/12,00

Dalja e dytë: 13,00/13,30

“San Giuseppe da Copertino” rruga Michelangelo, 100 Osimo **Tel. 071/7231614**

E Hënë – e Premte 8.00-16.00

Dalja e parë: 11,45/12,00

Dalja e dytë: 13,15/13,45

“Seksioni Montessoriana” lagjja Osimo Stazione rruga D’Azeglio, 10 **Tel. 071/781301**

E Hënë – e Premte 7:45-15:45

Dalja e parë: 11,30/12,00

Dalja e dytë: 13,15/14,00

SHKOLLA FILLORE (KLASAT 1- 5)

“Bruno da Osimo” rruga S. Lucia,10 **Tel. 071/7131569**

Zyra e Drejtorit (071/714528)

ofron oraret **Kohë Normale – Kohë të plotë – Kohë të gjatë**

“Madre Teresa di Calcutta” rruga D’Azeglio, 10 **Tel. 071/781301**

ofron oraret **Kohë Normale – Kohë të plotë**

“Scuola Arcobaleno” rruga G. Pascoli **Tel. 071/7202118**

ofron orarin **Kohë Normale**

Koha normale për tre javë ofron 29 orë (5 orë nga e hëna deri të premten nga ora 8.00 deri në 13.00); Të shtunën do të ketë mësim për 4 orë nga ora 8.00 deri në 12.00; dhe një javë do të jetë me 25 orë me të shtunën të lirë.

Koha e zgjatur ka 29 orë në javë të zhvilluara nga e hëna deri të premten nga ora 8.00 deri në 13.00 me dy pasdite të martën dhe të enjten nga ora 14.00 deri në orën 16.00, me opsionin e mensës nga ora 13,00 deri në orën 14,00.

Koha e plotë ofron 40 orë në javë: 27 kurrikula mësimore + 3 me zgjedhje dhe 10 opsione të mensës nga ora 8.00 deri 16.00 **nga e hëna deri të premten.**

CIKLI I DYTË I NËNTËVJEÇARES (KLASAT 6-7-8)

Osimo Centro-San Biagio “Christine Krueger” Sheshi Bellini, n.1 Tel. 071/7134083
Rruga G. Pascoli, San Biagio Tel. 071/7202118
Osimo Stazione “Giovanni Paolo II” Rruga D’Azeglio, n.11 Tel. 071/781157

Mësimi mbahet nga e hëna deri të shtunën nga ora 8:00 deri në orën 13:00.

Është e nevojshme që prinderit të respektojnë ORARIN e hyrjes dhe daljes në përputhje me orët e mësimi.

Çdo komunikim shkollë-familje duhet të jetë i shkruar në DITARIN e marrë nga Shkolla jonë Gjithëpërfshirëse.

MUNGESAT nga shkolla duhet të jenë të justifikuar nga prindi, ose kushdo që merr vendin e tyre, nëpërmjet komunikimit në ditarin e shkollës.

DALJET E HERSHME duhet të autorizohen shprehimisht nga prindi ose kushdo që merr vendin e tyre, i cili duhet të bëjë të njohur shkollës si orën ashtu edhe ditën në të cilën studenti do të largohet para kohe nga mësimi. Kjo duhet të bëhet nëpërmjet komunikimit në ditarin e shkollës.

Për çdo AUTORIZIM të nevojshëm (eskursion mësimor, dalje me njoftime private, etj ...), ju lutem vizitoni faqen e internetit të shkollës ose u kërkoni informacione mesuesëve.

MUNGESA nga shkolla për një periudhë ME TE GJATE se 5 ditë për SEMUNDJE duhet të justifikohet me certifikatë mjeksore nga një pediatër ose mjek.

Për fëmijët që ndjekin kopshtin dhe shkollën fillore, prinderit duhet të raportojnë çdo NDRYSHIM në USHQIMIN e shërbimit të mensës, ju lutem kontaktoni ASSO (tel).

Në shkollë nuk mund të administrohen ILACE fëmijëve, përveçse në raste të veçanta dhe sipas procedurës. Për shpërndarjen e ilaceve, edhe pse të buta, dhe për përdorim shëndetësor, prindi duhet të paraqesë një kërkesë me të cilën bashkëngjitet, nëse është e mundur, recetën e mjekut.

Në Istitutin tonë Gjithëpërfshirës ekziston sporteli BES (për nevoja arsimore të veçanta) dhe DSA (për rregullimet specifike të mësimnxënies) që ka një mësues të specializuar, detyra e të cilit është të sigurojë informacion dhe ndihmën për familjet që kanë nevojë për fëmijët e tyre. Përveç kësaj ka edhe një shërbim KESHILLIMI që u drejtohet prindërve dhe nxënësve për tu ofruar atyre mbështetje për probleme psikologjike të hasura.

Në urdhëresa të ndryshme të shkollës është e nevojshme që studentët të kenë MATERIALE të veçantë ARSIMORE të cilat postohen në faqen e shkollës në internet, por për sqarime të mëtejshme është e rëndësishme të kontaktohen mësuesit.

Për aktivitetin fizik në PALESTER duhet të sjellin këpucë, një bluze për tu ndërruar dhe një peshqir.

Me rastin e DITELINDJEVE, ata që duan, mund të sjellin në shkolle ëmbëlsira jo të përgatitura në shtëpi, por të blera dhe të paketuara me etiketë sipas normës.

Për përdorimin korrekt të PAJISJEVE DIXHITALE (kompjuter, i-pad, tablet, etj ...) duhen ndjekur rregullat përkatëse të raportuara edhe në ditarin e shkollës.

Në shkollë nuk duhen sjell GJERA PERSONALE me VLERE për shkak se në rast të humbjes apo dëmtimit të tyre personeli i shkollës nuk mban përgjegjësi.